

RREGULLORE

**“PËR UDHËZIMET E BASHKIMIT EVROPIAN PËR ZHVILLIMIN E RRJETIT
TRANS-EVROPIAN TË TRANSPORTIT”**

Ndryshuar nga:

- ▶ M1 Rregullore Deleguese të Komisionit (EU) nr. 473/2014 e 17 janar 2014
- ▶ M2 Rregullore Deleguese të Komisionit (EU) nr. 2016/758 e 4 shkurt 2016
- ▶ M3 Rregullore Deleguese të Komisionit (EU) nr. 2017/849 e 7 dhjetor 2016
- ▶ M4 Rregullore Deleguese të Komisionit (EU) nr. 2019/254 e 9 nëntor 2018

**KREU I
PARIME TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Fusha e zbatimit**

Kjo rregullore:

1. përcakton udhëzimet për zhvillimin e rrjetit trans-Evropian të transportit, që përfshin një strukturë me dy nivele që përmban një rrjet gjithëpërfshirës dhe një rrjet kryesor, ku ky i fundit përcaktohet në bazë të rrjetit gjithëpërfshirës.
2. identifikon projektet me interes të përbashkët dhe specifikon kërkesat që duhen përmbushur për administrimin e infrastrukturës së rrjetit trans-Evropian të transportit.
3. cakton prioritetet për zhvillimin e rrjetit trans-Evropian të transportit.
4. parashikon marrjen e masave për realizimin e rrjetit trans-Evropian të transportit. Zbatimi i projekteve me interes të përbashkët varet nga shkalla e tyre e maturitetit, nga përputhshmëria me procedurat ligjore të Bashkimit Evropian dhe ato të brendshme, si dhe nga disponueshmëria e burimeve financiare, pa paragjykuar angazhimin financiar të një shteti anëtar ose të Bashkimit Evropian.

**Neni 2
Qëllimi**

1. Kjo rregullore zbatohet për rrjetin trans-Evropian të transportit, që tregohet në hartat e përfshira në Shtojcën I. Rrjeti trans-Evropian i transportit përfshin infrastrukturën e transportit dhe aplikacionet telematike, si dhe masat që nxisin administrimin efikas dhe të përdorimit të kësaj infrastrukture, dhe që lejojnë ngritjen dhe funksionimin e shërbimeve të qëndrueshme dhe efikase të transportit.
2. Infrastruktura e rrjetit trans-Evropian të transportit përbëhet nga infrastruktura e transportit hekurudhor, e transportit në rrugët ujore të brendshme, transportit rrugor, transportit detar, transportit ajror dhe transportit multimodal, siç përcaktohet në seksionet përkatëse të kapitullit II.

Neni 3 Përkufizime

Për qëllimet e kësaj rregulloreje zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

- a) "projekt me interes të përbashkët" është çdo projekt i zhvilluar sipas kërkesave dhe në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje;
- b) "vend fqinj" është vendi që përfshihet në fushën e zbatimit të Politikës Evropiane të Fqinjësisë, duke përfshirë Partneritetin Strategjik, Politikën e Zgjerimit, dhe Zonën Ekonomike Evropiane ose Shoqatën Evropiane për Tregtinë e Lirë;
- c) "vend i tretë" është çdo vend fqinj ose çdo vend tjetër me të cilin Bashkimi Evropian mund të bashkëpunojë për arritjen e objektivave të ndjekura nga kjo rregullore;
- d) "vlerë e shtuar evropiane" është vlera e projektit, e cila, përveç vlerës së mundshme për secilin shtet anëtar përkatës më vete, sjell përmirësime të konsiderueshme në lidhjet e transportit ose për flukset e transportit ndërmjet shteteve anëtare, të cilat mund të provohen duke iu referuar përmirësimeve në efikasitet, qëndrueshmëri, konkurrueshmëri ose në kohezion, në përputhje me objektivat e përcaktuara në nenin 4;
- e) "administrues i infrastrukturës" është çdo organ ose sipërmarrje që është përgjegjës, në mënyrë të veçantë, për ngritjen ose mirëmbajtjen e infrastrukturës së transportit. Gjithashtu, kjo mund të përfshijë administrimin e kontrollit të infrastrukturës dhe të sistemeve të sigurisë;
- f) "aplikacione telematike" janë sistemet që përdorin informacionin, komunikimin, teknologjitë e lundrimit ose të pozicionimit/lokalizimit, me qëllim administrimin e infrastrukturës, të lëvizshmërisë dhe të trafikut në rrjetin trans-Evropian të transportit, dhe për sigurimin e shërbimeve me vlerë të shtuar për qytetarët dhe operatorët, duke përfshirë sistemet për përdorimin e rrjetit në mënyrë të sigurt, pa dëmtuar mjedisin dhe me përdorim të efikas të kapaciteteve të rrjetit. Gjithashtu, kjo mund të përfshijë pajisjet në bord, me kusht që të formojnë një sistem të pandashëm me komponentët përkatës të infrastrukturës. Ato përfshijnë sistemet, teknologjitë dhe shërbimet e përmendura në shkronjat g) deri në l);
- g) "sistem inteligjent i transportit" (ITS) është sistemi siç specifikohet në Direktivën 2010/40/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit¹;
- h) "sistem i administrimit të trafikut ajror" është sistemi siç specifikohet në Rregulloren (KE) nr. 552/2004 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit² dhe në Master Planin për Administrimin e Trafikut Ajror të Evropës (ATM) të specifikuar në Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 219/2007³;
- i) "Sisteme të Monitorimit dhe Informimit të Trafikut të Mjeteve Lundruese" (VTMIS) janë sisteme që përdoren për monitorimin dhe administrimin e trafikut dhe të transportit detar, duke përdorur informacionin nga sistemet e identifikimit automatik të anijeve (AIS), nga identifikimi dhe lokalizimi në distancë të largët i anijeve (LRIT), dhe sistemet radare bregdetare dhe radio-komunikimet, siç parashikohen në Direktivën 2002/59/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit⁴, dhe përfshin integrimin e sistemeve kombëtare të informacioneve detare përmes "SafeSeaNet";

¹ Direktiva 2010/40/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 7 korrik 2010 "Për kuadrin e përdorimit të Sistemeve Inteligjente të Transportit në fushën e transportit rrugor dhe për lidhjen me mënyrat e tjera të transportit" (Gazeta Zyrtare L 207, 6.8.2010, f. 1).

² Rregullorja (KE) nr. 552/2004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 10 mars 2004 "Për ndërvëprimin e rrjetit evropian për administrimin e trafikut ajror" (Rregullorja për ndërvëprueshmërinë) (Gazeta Zyrtare L 96, 31.3.2004, f. 26).

³ Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 219/2007 e datës 27 shkurt 2007 "Për themelimin e një sipërmarrjeje të përbashkët për të zhvilluar sistemin e ri evropian për administrimin e trafikut ajror" (SESAR) (Gazeta Zyrtare L 64, 2.3.2007, f. 1).

⁴ Direktiva 2002/59/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 27 qershor 2002 "Për krijimin e sistemit të Komunitetit për informimin dhe monitorimin e trafikut të mjeteve lundruese", dhe që ndryshon Direktivën e Këshillit 93/75/KEE (Gazeta Zyrtare L 208, 5.8.2002, f. 10).

j) "Shërbimet e Informacionit për Lumenjtë (RIS)" janë teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit për rrugët ujore të brendshme, siç përcaktohet në Direktivën 2005/44/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit⁵;

k) "shërbime elektronike të transportit detar" janë shërbimet që përdorin teknologji informacioni të avancuara dhe ndërvepruese në sektorin e transportit detar, për të thjeshtuar procedurat administrative dhe për të lehtësuar qarkullimin e ngarkesës në det dhe në hapësirat e portit, duke përfshirë shërbimet në një dritare të vetme, si p.sh. dritarja e vetme e integruar për shërbimet detare, e parashikuar në Direktivën 2010/65/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit⁶, sistemet portuale komunitare dhe sistemet përkatëse të informacionit doganor;

l) "Sistem Evropian për Administrimin e Trafikut Hekurudhor" (ERTMS) është sistemi i përcaktuar në Vendimin e Komisionit 2006/679/KE⁷ dhe në Vendimin e Komisionit 2006/860/KE⁸;

m) "seksion ndërkufitar" është seksioni që garanton vazhdimësinë e projektit me interes të përbashkët ndërmjet nyjave më të afërta urbane nga të dyja anët e kufirit të dy shteteve anëtare ose ndërmjet një shteti anëtar dhe një vendi fqinj;

n) "transport multimodal" është transporti i udhëtarëve ose i mallrave, ose i të dyjave, ku përdoren dy ose më shumë mënyra transporti;

o) "ndërveprim" është aftësia, përfshirë të gjitha kushtet rregullatore, teknike dhe operative të infrastrukturës së një mënyre transporti, që lejon flukset e sigurta dhe të pandërprera të trafikut, të cilat arrijnë nivelet e kërkuara të performancës për këtë infrastrukturë ose mënyrë transporti;

p) "nyje urbane" është zona urbane, ku infrastruktura e transportit e rrjetit trans-Evropian të transportit, si p.sh. portet, duke përfshirë терминаlet e udhëtarëve, aeroportet, stacionet hekurudhore, platformat logjistike dhe терминаlet e mallrave që ndodhen brenda dhe përreth zonës urbane, lidhet me pjesët e tjera të kësaj infrastrukture dhe me infrastrukturën e trafikut rajonal ose lokal;

q) "bllokim" është barriera fizike, teknike ose funksionale që sjell dështimin e sistemit, e cila ndikon në vazhdimësinë e flukseve të distancave të largëta ose ndërkufitare dhe mund të tejkalohet përmes krijimit të infrastrukturës së re ose përmes përmirësimit të konsiderueshëm të infrastrukturës fizike që mund të sjellë përmirësime të ndjeshme për zgjidhjen e kufizimeve si pasojë e bllokimeve;

r) "platformë logjistike" është zona që lidhet drejtpërdrejt me infrastrukturën e transportit të rrjetit trans-Evropian të transportit, ku përfshihet të paktën një terminal mallrash, dhe që lejon kryerjen e aktiviteteve logjistike;

s) "terminal mallrash" është struktura e pajisur për transportin ndërmjet të paktën dy mënyrash transporti ose ndërmjet dy sistemesh të ndryshme hekurudhore, si dhe për magazinimin e përkohshëm të mallrave, si p.sh. porte, porte të brendshme, aeroporte dhe terminale hekurudhore-rrugore;

t) "analizë social-ekonomike e kosto-përfitimit" është një vlerësim sasior *ex-ante* (i pritshëm), për vlerën e projektit bazuar në një metodologji të njohur, duke marrë në

⁵ Direktiva 2005/44/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 7 shtator 2005 "Për harmonizimin e shërbimeve të informacionit për lumenjtë (RIS) në rrugët e brendshme ujore në Komunitet" (Gazeta Zyrtare L 255, 30.9.2005, f. 152).

⁶ Direktiva 2010/65/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 tetor 2010 "Për procedurat e raportimit për anijet që mbërrijnë dhe/ose nisen nga portet e shteteve anëtare", dhe që shfuqizon Direktivën 2002/6/KE (Gazeta Zyrtare L 283, 29.10.2010, f. 1).

⁷ Vendimi i Komisionit 2006/679/KE i datës 28 mars 2006 "Për kushtet teknike të ndërveprimit në lidhje me nënsistemin e komandë-kontrollit dhe të sinjalizimit të sistemit hekurudhor trans-Evropian tradicional" (Gazeta Zyrtare L 284, 16.10.2006, f. 1).

⁸ Vendimi i Komisionit 2006/860/KE i datës 7 nëntor 2006 "Për kushtet teknike të ndërveprimit në lidhje me nënsistemin e komandë-kontrollit dhe të sinjalizimit të sistemit hekurudhor trans-evropian të shpejtësisë së lartë" dhe që ndryshon shtojcën A të Vendimit 2006/679/KE "Për kushtet teknike të ndërveprimit në lidhje me nënsistemin e komandë-kontrollit dhe të sinjalizimit të sistemit hekurudhor trans-Evropian tradicional" (Gazeta Zyrtare L 342, 7.12.2006, f. 1).

konsideratë të gjitha përfitimet dhe kostot përkatëse sociale, ekonomike dhe ato klimatike dhe mjedisore. Analiza e kostove dhe përfitimeve për aspektet klimatike dhe ato mjedisore bazohet në vlerësimin e ndikimit mjedisor që kryhet në përputhje me Direktivën 2011/92/BE⁹;

u) "rrjeti i izoluar" është rrjeti hekurudhor i një shteti anëtar, ose një pjesë e tij, me gjerësi të ndryshme nga përmasat nominale standarde evropiane (1435 mm), për të cilin investime të caktuara në infrastrukturë nuk mund të justifikohen në lidhje me kosto-përfitimet ekonomike, për shkak të specifikave të këtij rrjeti që lindin nga izolimi gjeografik ose vendndodhja periferike;

v) "rajon NNJTS (NUTS)" është një rajon siç përcaktohet në Nomenklaturën e Njësive Territoriale për Statistikat;

w) "lëndë djegëse alternative të pastra" janë lëndët djegëse si elektriciteti, hidrogjeni, biokarburantet (e lëngshme), lëndët djegëse sintetike, metani (gazi natyror (CNG dhe GNL) dhe biometani) dhe gazi i lëngshëm i naftës (GLN), të cilat shërbejnë, të paktën pjesërisht, si zëvendësuese për burimet e naftës fosile në furnizimin me energji të transportit, kontribuojnë në dekarbonizimin e saj dhe përmirësojnë performancën e sektorit të transportit në mjedis.

Neni 4

Objektivat e rrjetit trans-Evropian të transportit

Rrjeti trans-Evropian i transportit fuqizon kohezionin social, ekonomik dhe territorial të Bashkimit Evropian dhe kontribuon në krijimin e hapësirës së vetme evropiane të transportit, e cila është efikase dhe e qëndrueshme, rrit përfitimet për përdoruesit e saj dhe mbështet rritjen gjithëpërfshirëse. Ai duhet të provojë vlerën e shtuar evropiane, duke kontribuar në objektivat e përcaktuara në katër kategoritë si më poshtë:

a) Kohezioni përmes:

i) aksesueshmërisë dhe lidhjes së të gjitha rajoneve të Bashkimit Evropian, duke përfshirë rajonet e largëta, ato më të largëta, rajonet ishullore, periferike dhe malore, si dhe zonat me popullsi të rrallë;

ii) reduktimit të diferencave në cilësinë e infrastrukturës ndërmjet shteteve anëtare;

iii) ndërlidhjes, si për trafikun e udhëtarëve, ashtu dhe për trafikun e mallrave, ndërmjet infrastrukturave të transportit, nga njëra anë për trafikun me distanca të largëta, dhe nga tjetra për trafikun rajonal dhe lokal;

iv) një infrastrukture transporti që pasqyron rrethanat specifike në pjesë të ndryshme të Bashkimit Evropian dhe siguron mbulim të balancuar për të gjitha rajonet evropiane;

b) Efikasiteti përmes:

i) eliminimit të bllokimit të trafikut dhe lidhjeve ndërmjet nyjeve lidhëse që mungojnë, si brenda infrastrukturave të transportit, ashtu edhe në pikat lidhëse ndërmjet tyre, brenda territoreve të shteteve anëtare dhe ndërmjet tyre;

ii) ndërlidhjes dhe ndërveprimit të rrjeteve kombëtare të transportit;

iii) integritimit dhe ndërlidhjes optimale për të gjitha mënyrat e transportit;

iv) nxitjes së transportit të cilësisë së lartë, ekonomikisht efikas, i cili kontribuon në rritjen e mëtejshme ekonomike dhe të konkurrueshmërisë;

v) përdorimit efikas të infrastrukturës së re dhe asaj ekzistuese;

vi) zbatimit kosto-efektiv të koncepteve inovative teknologjike dhe operative;

⁹ Direktiva 2011/92/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 dhjetor 2011 "Për vlerësimin e ndikimeve në mjedis të disa projekteve publike dhe private" (Gazeta Zyrtare L 26, 28.1.2012, f. 1).

- c) Qëndrueshmëria përmes:
- i) zhvillimit të të gjitha llojeve të transportit, në mënyrë harmonike duke garantuar transport të qëndrueshëm dhe ekonomikisht efikas në planin afatgjatë;
 - ii) kontributit në objektivat e shkarkimeve të ulëta të gazeve me efekt serrë, të transportit të pastër dhe me karbon të ulët, të sigurisë së lëndëve djegëse, të reduktimit të kostove të jashtme dhe të mbrojtjes së mjedisit;
 - iii) nxitjes së transportit me nivele të ulëta karboni, me synimin për të arritur reduktime të ndjeshme në shkarkimet e CO₂ deri në vitin 2050, në përputhje me objektivat përkatëse të Bashkimit Evropian për reduktimin e CO₂;
- d) Rritja e përfitimeve për përdoruesit e tij përmes:
- i) plotësimin të nevojave për lëvizshmërinë dhe transportin e përdoruesve të tij brenda Bashkimit Evropian dhe në lidhjet me vendet e treta;
 - ii) garantimit të transportit të sigurt dhe me standarde të një cilësie të lartë, si për udhëtarët, ashtu dhe për mallrat;
 - iii) mbështetjes së lëvizshmërisë, edhe në rastet e fatkeqësive natyrore ose të shkaktuara nga njeriu, dhe garantimit të aksesit në shërbimet e emergjencës dhe të shpëtimit;
 - iv) caktimit të kërkesave për infrastrukturën, në veçanti në fushën e ndërveprimit, mbrojtjes dhe të sigurisë, të cilat do të garantojnë cilësinë, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve të transportit;
 - v) aksesit për të moshuarit, personat me lëvizshmëri të reduktuar dhe udhëtarët me aftësi të kufizuar.

Neni 5

Burimi - Rrjet efikas

1. Rrjeti trans-Evropian i transportit do të planifikohet, zhvillohet dhe operohet me efikasitet të burimeve, përmes:

- a) zhvillimit, përmirësimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës ekzistuese të transportit;
- b) optimizimit të integritetit dhe ndërlidhjes së infrastrukturës;
- c) përdorimit të teknologjive të reja dhe të aplikacioneve telematike, kur ky përdorim justifikohet ekonomikisht;
- d) marrjes në konsideratë të sinergjive të mundshme me rrjetet e tjera, në veçanti me rrjetet trans-Evropiane të energjisë dhe të telekomunikacionit;
- e) vlerësimit të ndikimeve strategjike në mjedis, duke krijuar planet dhe programet e duhura, si dhe vlerësimit të ndikimeve në zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike;
- f) masave për planifikimin dhe zgjerimin e kapacitetit të infrastrukturës, aty ku është e nevojshme;
- g) vlerësimit të duhur të cenueshmërisë së infrastrukturës së transportit në lidhje me ndryshimet klimatike, si dhe me fatkeqësitë natyrore ose të shkaktuara nga njeriu.

2. Gjatë planifikimit dhe zhvillimit të rrjetit trans-Evropian të transportit, shtete anëtare marrin në konsideratë rrethanat e veçanta në pjesë të ndryshme të Bashkimit Evropian, veçanërisht aspektet e turizmit dhe veçoritë topografike të rajoneve përkatëse. Ato mund të përshtatin rakordimin e hollësishëm të korridoreve të seksioneve brenda kufijve të treguar në nenin 49, paragrafi 4, shkronja c), duke garantuar përputhjen me kërkesat e përcaktuara në të.

Neni 6

Struktura me dy nivele e rrjetit trans-Evropian të transportit

1. Zhvillimi gradual i rrjetit trans-Evropian të transportit do të arrihet në mënyrë të veçantë përmes realizimit të strukturës me dy nivele për këtë rrjet, sipas qasjes metodologjike koherente dhe transparente, që përfshin rrjetin gjithëpërfshirës dhe rrjetin kryesor.

2. Rrjeti gjithëpërfshirës përbëhet nga të gjitha infrastrukturat ekzistuese dhe të planifikuara të rrjetit trans-Evropian të transportit, si dhe nga të gjitha masat që nxisin përdorimin e kësaj infrastrukture në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme në drejtim të aspektit social dhe mjedisor. Rrjeti identifikohet dhe zhvillohet në përputhje me kreun II.

3. Rrjeti kryesor përbëhet nga ato pjesë të rrjetit gjithëpërfshirës, të cilat kanë rëndësi më të lartë strategjike për arritjen e objektivave për zhvillimin e rrjetit trans-Evropian të transportit. Rrjeti identifikohet dhe zhvillohet në përputhje me kreun III.

Neni 7

Projektet me interes të përbashkët

1. Projektet me interes të përbashkët kontribuojnë në zhvillimin e rrjetit trans-Evropian të transportit përmes krijimit të infrastrukturës së re të transportit, rehabilitimit dhe përmirësimit të infrastrukturës ekzistuese të transportit, si dhe përmes masave që nxisin përdorimin efikas të burimeve të rrjetit.

2. Një projekt me interes të përbashkët duhet të:

- a) kontribuojë në drejtim të arritjes së objektivave të të paktën dy prej katër kategorive të përcaktuara në nenin 4;
- b) jetë në përputhje me kapitullin II, dhe kur bëhet fjalë për rrjetin kryesor, duhet të jetë në përputhje edhe me kapitullin III;
- c) jetë ekonomikisht rentabël në bazë të analizës social-ekonomike të kosto-përfitimit;
- d) demonstrojë vlerën e shtuar evropiane.

3. Një projekt me interes të përbashkët mund të përfshijë të gjithë ciklin e tij, duke përfshirë studimet e fizibilitetit dhe procedurat e dhënies së lejes, të zbatimit dhe të vlerësimit.

4. Shtetet anëtare marrin të gjitha masat e nevojshme për të garantuar që projektet të realizohen në përputhje me ligjet përkatëse të Bashkimit Evropian dhe me legjislacionin e brendshëm, në veçanti me aktet ligjore të Bashkimit Evropian për mjedisin, mbrojtjen e klimës, sigurinë, konkurrencën, ndihmën shtetërore, prokurimet publike, shëndetin publik dhe aksesueshmërinë.

5. Projektet me interes të përbashkët gëzojnë të drejtën e përfitimit të asistencës financiare të Bashkimit Evropian nën instrumentet e disponueshme për rrjetin trans-Evropian të transportit.

Neni 8

Bashkëpunimi me vendet e treta

1. Bashkimi Evropian mund të mbështesë, duke përfshirë anën financiare, projektet me interes të përbashkët që lidhin rrjetin trans-Evropian të transportit me rrjetet e infrastrukturës së vendeve fqinje, për sa kohë që këto projekte:

- a) lidhin rrjetin kryesor në pikat e kalimit të kufirit dhe infrastrukturën e nevojshme për garantimin e fluksit pa ndërprerje të trafikut, të inspektimeve kufitare, të mbikëqyrjes së kufijve dhe të procedurave të tjera të kontrollit kufitar;
 - b) garantojnë lidhjen ndërmjet rrjetit kryesor dhe rrjeteve të transportit të vendeve të treta, me qëllim fuqizimin e rritjes ekonomike dhe konkurrueshmërinë;
 - c) plotësojnë infrastrukturën e transportit në vendet e treta, të cilat shërbejnë si lidhje ndërmjet pjesëve të rrjetit kryesor të Bashkimit Evropian;
 - d) vënë në zbatim sistemet e administrimit të trafikut në këto vende;
 - e) nxisin përdorimin e transportit detar dhe të "autostradave detare", duke përjashtuar mbështetjen financiare për portet e vendeve të treta;
 - f) lehtësojnë transportin në rrugët e brendshme ujore me vendet e treta.
- Këto projekte duhet të rrisin kapacitetin ose dobinë e rrjetit trans-Evropian të transportit në një ose më shumë shtete anëtare.

2. Pa cenuar paragrafin 1, Bashkimi Evropian mund të bashkëpunojë me vendet e treta për nxitjen e projekteve të tjera, duke mos ofruar mbështetje financiare, për sa kohë që këto projekte kanë si synim:

- a) të nxisin ndërveprimin mes rrjetit trans-Evropian të transportit dhe rrjeteve të vendeve të treta;
- b) të nxisin zgjerimin e politikës së rrjetit trans-Evropian të transportit në vendet e treta;
- c) të lehtësojnë transportin ajror me vendet e treta, me qëllim nxitjen e rritjes ekonomike efikase dhe të qëndrueshme dhe konkurrueshmërinë, duke përfshirë zgjerimin e "qiellit të vetëm evropian" dhe përmirësimin e bashkëpunimit për administrimin e trafikut ajror;
- d) të lehtësojnë transportin detar dhe promovojnë "autostradat detare" për vendet e treta.

3. Projektet që përfshihen në shkronjat a) dhe d) të paragrafit 2 duhet të jenë në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitullit II.

4. Shtojca III përfshin hartat treguese të rrjetit trans-Evropian të transportit që shtrihet në shtetet fqinje specifike.

5. Për nxitjen e projekteve me interes të përbashkët, Bashkimi Evropian mund të përdorë me vendet fqinje instrumente koordinimi dhe financiare ekzistuese, ose të ngrejë dhe të përdorë të reja, si p.sh. Instrumenti i Financimit të Projekteve të Fqinjësisë (NIF) ose Instrumenti për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA).

6. Dispozitat e këtij neni i nënshtrohen procedurave përkatëse të marrëveshjeve ndërkombëtare, siç përcaktohen në nenin 218 të TFBE-së (Traktati i Bashkimit Evropian dhe Traktati për funksionimin e Bashkimit Evropian).

KREU II RRJETI GJITHËPËRFSHIRËS

Neni 9

Dispozita të përgjithshme

1. Rrjeti gjithëpërfshirës do të:
 - a) jetë siç specifikohet në hartat dhe listat e Shtojcës I dhe në pjesën 2 të Shtojcës II;

- b) specifikohet më tej përmes përshkrimit të elementeve përbërëse të infrastrukturës;
- c) përmbush kërkesat për infrastrukturën e transportit, të përcaktuara në këtë kapitull;
- d) përbën bazën për identifikimin e projekteve me interes të përbashkët;
- e) merr në konsideratë kufizimet fizike dhe veçoritë topografike të infrastrukturave të transportit të shteteve anëtare, siç përcaktohet në kushtet teknike të ndërveprimit (KTN).

2. Shtetet anëtare duhet të bëjnë të gjithë përpjekjet e mundshme, me qëllim përfundimin e rrjetit gjithëpërfshirës dhe përmbushjen e të gjitha dispozitave të këtij kapitulli deri më 31 dhjetor 2050.

Neni 10 Prioritetet e përgjithshme

1. Për zhvillimin e rrjetit gjithëpërfshirës, duhet t'i jepet prioritet i përgjithshëm i masave të nevojshme për:

- a) garantimin e përmirësimit të aksesueshmërisë dhe lidhjes për të gjitha rajonet e Bashkimit Evropian, ndërkohë që merren në konsideratë rastet e veçanta të ishujve, të rrjeteve të izoluar dhe rajoneve me popullsi të rrallë, të largëta dhe ato më të largëta;
- b) garantimin e integritetit optimal të mënyrave të transportit dhe të ndërveprimit mes mënyrave të transportit;
- c) plotësimin e lidhjeve që mungojnë dhe eliminimin e bllokimit të trafikut, veçanërisht në seksionet ndërkufitare;
- d) nxitjen e përdorimit efikas dhe të qëndrueshëm të infrastrukturës dhe, aty ku është e nevojshme, të rritjes së kapacitetit;
- e) përmirësimin ose ruajtjen e cilësisë së infrastrukturës në lidhje me sigurinë, efikasitetin, aspektet klimatike dhe, sipas rastit, me aftësinë ripërtëritëse pas fatkeqësive, me kushtet sociale, me aksesueshmërinë për të gjithë përdoruesit, duke përfshirë të moshuarit, personat me lëvizshmëri të reduktuar dhe udhëtarët me aftësi të kufizuar, si dhe për përmirësimin ose ruajtjen e cilësisë së shërbimeve dhe të vazhdimësisë së flukseve të trafikut;
- f) zbatimin dhe përdorimin e aplikacioneve telematike dhe për nxitjen e zhvillimit të teknologjisë inovative.

2. Për të plotësuar masat e përcaktuara në paragrafin 1, vëmendje e veçantë i duhet kushtuar masave të nevojshme për:

- a) garantimin e sigurisë së lëndëve djegëse përmes rritjes së efikasitetit të energjisë dhe nxitjes së përdorimit të sistemeve shtytëse dhe të burimeve alternative të energjisë, në veçanti të atyre me nivele të ulëta karboni ose zero;
- b) zbutjen e ekspozimit të zonave urbane ndaj ndikimeve negative të tranzitit të transportit hekurudhor dhe rrugor;
- c) eliminimin e barrierave administrative dhe teknike, në veçanti për ndërveprimin e rrjetit trans-Evropian të transportit dhe për konkurrencën.

SEKSIONI 1 INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT HEKURUDHOR

Neni 11 **Elementët e infrastrukturës**

1. Në veçanti, infrastruktura e transportit hekurudhor përfshin:
 - a) linjat hekurudhore konvencionale dhe të shpejtësisë së lartë, duke përfshirë:
 - i) linjat dytësore;
 - ii) tunelet;
 - iii) urat;
 - b) терминалет e mallrave dhe platformat logjistike për transportin e mallrave brenda transportit hekurudhor dhe ndërmjet transportit hekurudhor dhe mënyrave të tjera të transportit;
 - c) stacionet përgjatë linjave hekurudhore, të përcaktuara në Shtojcën I, për transferimin e udhëtarëve brenda transportit hekurudhor dhe ndërmjet transportit hekurudhor dhe mënyrave të tjera të transportit;
 - d) lidhjet e stacioneve, të terminaleve të mallrave dhe të platformave logjistike me mënyra të tjera në rrjetin trans-Evropian të transportit;
 - e) pajisjet përkatëse;
 - f) aplikacionet telematike.
2. Linjat hekurudhore janë të paktën në një prej formave më poshtë:
 - a) linja hekurudhore për transportin me shpejtësi të lartë, të cilat janë:
 - i) linja hekurudhore të ndërtuara posaçërisht për shpejtësi të lartë, të barabartë ose mbi 250 km/orë;
 - ii) linja hekurudhore konvencionale, të përmirësuara posaçërisht për shpejtësi të rendit 200 km/orë;
 - iii) linja hekurudhore të shpejtësisë së lartë të përmirësuara në mënyrë të posaçme që kanë veçori specifike si rezultat i kufizimeve topografike, të relievit ose të planifikimit urban, për të cilat shpejtësia duhet të përshtatet për çdo rast. Kjo kategori gjithashtu përfshin linjat ndërlidhëse midis rrjeteve konvencionale dhe të shpejtësisë së lartë, linjat hekurudhore të kalimit në stacione, të aksesit në terminale, në depo etj., ku mjetet e transportit hekurudhor udhëtojnë me shpejtësi të zakonshme;
 - b) linja hekurudhore për transportin konvencional.
3. Pajisjet teknike në lidhje me linjat hekurudhore mund të përfshijnë sistemet e elektrifikimit, pajisjet për hipjen dhe zbritjen e udhëtarëve, dhe për ngarkimin dhe shkarkimin e ngarkesave në stacione, në platformat logjistike dhe në терминалет e mallrave. Ato mund të përfshijnë çdo pajisje, si p.sh. ato të ndryshimit automatik të shinave, të nevojshme për garantimin e operimit të sigurt dhe efikas të mjeteve, duke përfshirë reduktimin e ndikimit të tyre në mjedis dhe përmirësimin e ndërveprimit.

Neni 12 **Kërkesat e infrastrukturës së transportit**

1. Терминалет e mallrave duhet të lidhen me infrastrukturën rrugore ose, aty ku është e mundur, me infrastrukturën e rrugëve të brendshme ujore të rrjetit gjithëpërfshirës.
2. Shtetet anëtare garantojnë se infrastruktura hekurudhore:
 - a) përveç rastit të rrjeteve të izoluara, pajiset me ERTMS;

- b) është në përputhje me Direktivën 2008/57/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit¹⁰ dhe me masat zbatuese, me qëllim arritjen e ndërveprimit të rrjetit gjithëpërfshirës;
 - c) plotëson kërkesat e KTN-ve të miratuara në zbatim të nenit 6 të Direktivës 2008/57/KE, përveçse kur lejohet nga KTN-ja përkatëse ose sipas procedurës së parashikuar në nenin 9 të Direktivës 2008/57/KE;
 - d) përveç rastit të rrjeteve të izoluar, të elektrifikohet plotësisht në lidhje me vijat hekurudhore dhe, në masën që është e nevojshme për operimin e trenave elektrikë, në lidhje me linjat dytësore;
 - e) është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Direktivën 2012/34/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit¹¹, në lidhje me aksesin në терминаlet e mallrave.
3. Në raste të argumentuara saktë, me kërkesë të një shteti anëtar, Komisioni mund të lejojë përjashtime në lidhje me kërkesat që tejkalojnë ato të Direktivës 2008/57/KE, lidhur me ERTMS dhe me elektrifikimin.

Neni 13

Prioritetet për zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore

Për promovimin e projekteve me interes të përbashkët në lidhje me infrastrukturën hekurudhore, dhe në shtesë të prioriteteve të përgjithshme të përcaktuara në nenin 10, prioritet kanë:

- a) përdorimi i ERTMS;
- b) kalimi në gjerësinë nominale 1435 mm;
- c) zbutja e ndikimit të zhurmave dhe dridhjeve të shkaktuara nga transporti hekurudhor, në veçanti përmes masave për mjetet e transportit hekurudhor dhe infrastrukturën, duke përfshirë barrierat mbrojtëse ndaj zhurmave;
- d) përmbushja e kërkesave të infrastrukturës dhe rritja e ndërveprimit;
- e) rritja e sigurisë së kalimeve në nivel;
- f) aty ku është e përshtatshme, lidhja e infrastrukturës së transportit hekurudhor me infrastrukturën portuale të rrugëve të brendshme ujore.

SEKSIONI 2

INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT NË RRUGËT E BRENDSHME UJORE

Neni 14

Elementet e infrastrukturës

1. Në veçanti, infrastruktura e rrugëve të brendshme ujore përfshin:
 - a) lumenjtë;
 - b) kanalet;
 - c) liqenet;
 - d) infrastrukturën e lidhur me to, si portat, ashensorët, urat, rezervuarët dhe masat përkatëse për parandalimin e përmytjeve, të cilat mund të ndikojnë pozitivisht në lundrimin në rrugët e brendshme ujore;
 - e) portet e brendshme, përfshirë infrastrukturën e nevojshme për operacionet e transportit brenda zonës portuale;

¹⁰ Direktiva 2008/57/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 17 qershor 2008 "Për ndërveprimin e sistemit hekurudhor brenda Komunitetit" (Gazeta Zyrtare L 191, 18.7.2008, f. 1).

¹¹ Direktiva 2012/34/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 21 nëntor 2012 "Për krijimin e një zone të vetme hekurudhore evropiane" (Gazeta Zyrtare L 343, 14.12.2012, f. 32).

f) pajisjet përkatëse;
g) aplikacionet telematike, përfshirë RIS;
h) lidhjet e porteve të brendshme me mënyrat e tjera në rrjetin trans-Evropian të transportit.

2. Për të qenë pjesë e rrjetit gjithëpërfshirës, portet e brendshme duhet të kenë një vëllim total vjetor të transportit të mallrave mbi 500 000 ton. Vëllimi total vjetor i transportit të mallrave bazohet në mesataren më të fundit trevjeçare, të botuar nga Eurostat.

3. Pajisjet e lidhura me rrugët e brendshme ujore mund të përfshijnë pajisjet për ngarkimin dhe shkarkimin e ngarkesave në portet e brendshme. Në veçanti, këto pajisje mund të përfshijnë sistemet shtytëse dhe operative që reduktojnë ndotjen, p.sh. ndotjen e ujit dhe të ajrit, konsumin e energjisë dhe intensitetin e shkarkimeve të karbonit. Për të garantuar lundrimin gjatë gjithë vitit, ato mund të përfshijnë edhe impiante për grumbullimin e mbetjeve, impiantet për furnizimin me energji përmes rrjeteve tokësore, dhe impiantet për grumbullimin e vajrave të përdorur, si dhe pajisjet për thyerjen e akullit, shërbimet hidrologjike dhe pastrimet e portit dhe të rrugëve hyrëse në port.

Neni 15

Kërkesat e infrastrukturës së transportit

1. Shtetet anëtare duhet të garantojnë lidhjen e porteve të brendshme me infrastrukturën rrugore ose hekurudhore.

2. Portet e brendshme duhet të ofrojnë në mënyrë jodiskriminuese të paktën një terminal mallrash të hapur për të gjithë operatorët dhe të zbatojnë tarifa transparente.

3. Shtetet anëtare garantojnë që:

a) lumenjtë, kanalet dhe liqenet të përmbushin kërkesat minimale për rrugët ujore të klasës IV, siç parashikohet në klasifikimin e ri të rrugëve të brendshme ujore të përcaktuara në Konferencën Evropiane të Ministrave të Transportit (KEMT), dhe që të ketë vazhdimisht lartësi të lirë nën ura, pa cenuar nenet 35 dhe 36 të kësaj rregulloreje.

Në raste të argumentuara saktë, me kërkesë të një shteti anëtar, Komisioni mund të bëjë përjashtime nga kërkesat minimale për nivelin e thellësisë (nën 2,50 m) dhe për lartësinë minimale nën ura (nën 5,25 m);

b) lumenjtë, kanalet dhe liqenet të mirëmbahen, në mënyrë që të ruajnë statusin e mirë të lundrimit, duke respektuar legjislacionin e zbatueshëm për mjedisin;

c) lumenjtë, kanalet dhe liqenet të pajisen me RIS.

Neni 16

Prioritetet për zhvillimin e infrastrukturës së rrugëve të brendshme ujore

Për promovimin e projekteve me interes të përbashkët në lidhje me infrastrukturën e rrugëve të brendshme ujore, dhe në shtesë të prioritetëve të përgjithshme të përcaktuara në nenin 10, kanë përparësi:

a) për rrugët e brendshme ujore: zbatimi i masave të nevojshme për arritjen e standardeve të rrugëve ujore të klasës IV;

b) sipas rastit, arritja e standardeve më të larta për modernizimin e rrugëve ujore ekzistuese dhe për krijimin e rrugëve të reja ujore, në përputhje me aspektet teknike të infrastrukturës të ECMT, me qëllim plotësimin e kërkesave të tregut;

c) përdorimi i aplikacioneve telematike, përfshirë RIS;

d) lidhja e infrastrukturës së porteve të brendshme me infrastrukturën e transportit hekurudhor të mallrave dhe të transportit rrugor;

- e) kushtimi i vëmendjes së veçantë për lumenjtë me rrjedhje të lirë, që janë afër gjendjes natyrore dhe për rrjedhojë mund t'i nënshtrohen masave specifike;
- f) nxitja e transportit të qëndrueshëm në rrugët e brendshme ujore;
- g) modernizimi dhe zgjerimi i kapacitetit të infrastrukturës së nevojshme për operacionet e transportit brenda zonës portuale.

SEKSIONI 3 INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT RRUGOR

Neni 17

Elementet e infrastrukturës

1. Në veçanti, infrastruktura e transportit rrugor përfshin:

- a) rrugë të një cilësie të lartë, përfshirë:
 - i) urat;
 - ii) tunelet;
 - iii) nyjet rrugore;
 - iv) kryqëzimet;
 - v) kryqëzimet në disnivel;
 - vi) xhepat e ndalimit të emergjencës;
- b) zonat e parkimit dhe të qëndrimit;
- c) pajisjet përkatëse;
- d) aplikacionet telematike, përfshirë ITS;
- e) terminalët e mallrave dhe platformat logjistike;
- f) lidhjet e terminaleve të mallrave dhe platformave logjistike me mënyrat e tjera në rrjetin trans-Evropian të transportit;
- g) stacionet e autobusëve.

2. Rrugë të një cilësie të lartë, të përmendura në shkronjën a) të paragrafit 1, janë ato që luajnë një rol të rëndësishëm në trafikun e distancave të largëta të udhëtarëve dhe të mallrave, integrojnë qendrat kryesore urbane dhe ekonomike, ndërlidhen me mënyrat e tjera të transportit dhe lidhin rajonet malore, të largëta, pa dalje në det dhe ato periferike të NUTS 2 me rajonet qendrore të Bashkimit Evropian. Për të mundësuar trafikun e sigurt, këto rrugë duhet të mirëmbahen siç duhet.

3. Rrugët me cilësi të lartë duhet të projektohen dhe të ndërtohen posaçërisht për trafikun e mjeteve motorike, dhe mund të jenë autostrada, rrugë kryesore ose rrugë strategjike të zakonshme.

- a) Autostradë është rruga e projektuar dhe e ndërtuar posaçërisht për trafikun e mjeteve motorike, e cila nuk i shërben pronave përreth kufijve të saj dhe që:
 - i) përfshin karrexhata të ndara për të dy drejtimet e trafikut, përveç pikave të veçanta ose rasteve të përkohshme, të ndara nga njëra-tjetra me brez ndarës që nuk është menduar për lëvizjen ose, në mënyrë të jashtëzakonshme, me mjete të tjera;
 - ii) nuk kryqëzohet në nivel me asnjë rrugë, linjë hekurudhore ose tramvaji, me asnjë korsi biçikletash ose rrugë këmbësorësh; dhe
 - iii) është e pajisur me tabela të posaçme si autostradë.
- b) Rrugë kryesore është rruga e projektuar për trafikun e mjeteve motorike, që aksesohet kryesisht nga kryqëzimet në disnivel ose nga nyjet kryesore të kontrolluara dhe që:
 - i) nuk lejon ndalimin dhe parkimin në karrexhatat me lëvizje; dhe
 - ii) nuk kryqëzohet në nivel me asnjë shinë hekurudhore apo tramvaji.

c) Rruga strategjike e zakonshme është rruga, e cila nuk është autostradë ose rrugë kryesore, por gjithsesi konsiderohet si rrugë me cilësi të lartë, siç përmendet në paragrafët 1 dhe 2.

4. Pajisjet që lidhen me rrugët mund të përfshijnë, në mënyrë të veçantë, pajisjet për administrimin e trafikut, për informacionin dhe udhëzimet e itinerarit, për mbledhjen e tarifave nga përdoruesit e rrugës, ato për sigurinë, për reduktimin e ndikimeve negative në mjedis, për furnizimin me karburant ose rimbushjen e mjeteve me lëndë shtytëse alternative, dhe për zonat e parkimit të sigurt për mjetet tregtare.

Neni 18

Kërkesat e infrastrukturës së transportit

Shtetet anëtare do të garantojnë që:

- a) rrugët të jenë në përputhje me dispozitat e nenit 17, paragrafi 3, shkronjat a), b) ose c);
- b) siguria e infrastrukturës së transportit rrugor të ruhet, monitorohet dhe, kur është e nevojshme, të përmirësohet në përputhje me procedurën e parashikuar në Direktivën 2008/96/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit¹²⁾;
- c) tunelet rrugore me gjatësi mbi 500 m të jenë në përputhje me Direktivën 2004/54/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit¹³⁾;
- d) aty ku është e zbatueshme, të garantohet ndërveprimi i sistemeve të mbledhjes së pagesave për rrugët, në përputhje me Direktivën 2004/52/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit¹⁴⁾ dhe me Vendimin e Komisionit 2009/750/KE¹⁵⁾;
- e) çdo sistem inteligjent transporti që përdoret nga një autoritet publik, në lidhje me infrastrukturën e transportit rrugor, të jetë në përputhje me Direktivën 2010/40/BE dhe që të përdoret në mënyrë të pajtueshme me aktet e deleguara të miratuara në zbatim të kësaj direktive.

Neni 19

Prioritetet për zhvillimin e infrastrukturës rrugore

Për promovimin e projekteve me interes të përbashkët në lidhje me infrastrukturën rrugore, dhe në shtesë të prioriteteve të përgjithshme të përcaktuara në nenin 10, prioritet kanë:

- a) përmirësimi dhe nxitja e sigurisë rrugore;
- b) përdorimi i ITS-së, në veçanti sistemet multimodale të informacionit dhe të administrimit të trafikut dhe sistemet e integruara të komunikimit dhe të pagesave;
- c) prezantimi i teknologjive të reja dhe inovacionit për nxitjen e transportit me karbon të ulët;
- d) sigurimi i hapësirës së përshtatshme të parkimit për përdoruesit e mjeteve tregtare, duke ofruar nivelin e përshtatshëm të sigurisë;
- e) zbutja e mbingarkimit të trafikut në rrugët ekzistuese.

¹² Direktiva 2008/96/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 19 nëntor 2008 “Për administrimin e sigurisë në infrastrukturën rrugore” (Gazeta Zyrtare L 319, 29.11.2008, f. 59).

¹³ Vendimi nr. 2004/54/KE i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit i datës 29 prill 2004 “Për kërkesat minimale të sigurisë për tunelet e rrjetit trans-Evropian të transportit” (Gazeta Zyrtare L 167, 30.4.2004, f. 39).

¹⁴ Direktiva 2004/52/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 29 prill 2004 “Për ndërveprimin e sistemeve elektronike të mbledhjes së pagesave për rrugët” (Gazeta Zyrtare L 166, 30.4.2004, f. 124).

¹⁵ Vendimi i Komisionit 2009/750/KE i datës 6 tetor 2009 “Për përkufizimin e shërbimit elektronik evropian të mbledhjes së pagesave për rrugët dhe të elementeve teknike të tij” (Gazeta Zyrtare L 268, 13.10.2009, f. 11).

SEKSIONI 4
INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT DETAR DHE "AUTOSTRADAT DETARE"

Neni 20
Elementet e infrastrukturës

1. Në veçanti, infrastruktura e transportit detar përfshin:
- a) hapësirat detare;
 - b) kanalet detare;
 - c) portet detare, duke përfshirë infrastrukturën e nevojshme për operacionet e transportit brenda zonës portuale;
 - d) lidhjet e porteve me mënyrat e tjera në rrjetin trans-Evropian të transportit;
 - e) digat, portat dhe doket;
 - f) mjetet ndihmëse për lundrimin;
 - g) korridoret e afrimit në port dhe kanalet e hyrjes në port;
 - h) dallgëthyesit;
 - i) autostradat detare;
 - j) pajisjet përkatëse;
 - k) aplikacionet telematike, përfshirë shërbimet elektronike të transportit detar (*e-Maritime*) dhe VTMS.

2. Portet detare janë pikat hyrëse dhe dalëse për infrastrukturën tokësore të rrjetit gjithëpërfshirës. Ato duhet të përmbushin të paktën një prej kriterëve më poshtë:

- a) vëllimi total vjetor i qarkullimit të udhëtarëve të jetë mbi 0,1% të vëllimit total vjetor të qarkullimit të udhëtarëve në të gjithë portet detare të Bashkimit Evropian. Vlera referencë për këtë vëllim total është mesatarja më e fundit trevjeçare, që disponohet në bazë të statistikave të botuara nga Eurostat;
- b) vëllimi total vjetor i qarkullimit të ngarkesave, për përpunimin e ngarkesave rifuxho ose të ambalazhuara, të jetë mbi 0,1% të vëllimit total vjetor të ngarkesës së përpunuar në të gjithë portet detare të Bashkimit Evropian. Vlera referencë për këtë vëllim total është mesatarja më e fundit trevjeçare, që disponohet në bazë të statistikave të botuara nga Eurostat;
- c) porti detar ndodhet në një ishull dhe siguron pikën e vetme të aksesit në një rajon NUTS 3 të rrjetit gjithëpërfshirës;
- d) porti detar ndodhet në një rajon më të largët ose në zonë periferike, jashtë rrezes prej 200 km nga porti tjetër më i afërt në rrjetin gjithëpërfshirës.

3. Në veçanti, pajisjet e lidhura me infrastrukturën e transportit detar mund të përfshijnë pajisjet për administrimin e trafikut dhe të ngarkesave, me qëllim reduktimin e ndikimeve negative, duke përfshirë ndikimet negative në mjedis, dhe për përdorimin e lëndëve djegëse alternative, si dhe pajisjet për të garantuar lundrueshmërinë gjatë gjithë vitit, duke përfshirë pajisjet për thyerjen e akullit, studimet hidrologjike dhe për pastrimet, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e portit dhe të aksesit në port.

Neni 21
Autostradat detare

1. Autostradat detare, sipas mënyrës së tyre të përfaqësimit të dimensionit detar të rrjetit trans-Evropian të transportit, kontribuojnë drejt arritjes së hapësirës evropiane të transportit detar pa pengesa. Ato përbëhen nga itineraret e shkurtra detare, portet, infrastrukturat detare dhe pajisjet e lidhura me to, si dhe ambientet dhe formalitetet e thjeshtuara administrative që lejojnë operimin e udhëtimeve të shkurtra detare ose të

shërbimeve detare-lumore ndërmjet të paktën dy porteve, duke përfshirë rrugët ujore në brendësi të tokës. Autostradat detare përfshijnë:

a) lidhjet detare ndërmjet porteve detare të rrjetit gjithëpërfshirës ose ndërmjet një porti të rrjetit gjithëpërfshirës dhe një porti të një vendi të tretë, kur këto lidhje kanë rëndësi strategjike për Bashkimin Evropian;

b) impiantet portuale, терминаlet e mallrave, platformat logjistike dhe kantieret detare të ndodhura jashtë zonës portuale, por të lidhura me operacionet portuale, teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK), si p.sh. sistemet elektronike të administrimit të logjistikës, dhe procedurat e sigurisë, administrative dhe doganore, në të paktën një shtet anëtar;

c) infrastrukturën për aksesin e drejtpërdrejtë në tokë dhe në det.

2. Projektet me interes të përbashkët për autostradat detare në rrjetin trans-Evropian të transportit duhet të propozohet nga të paktën dy shtete anëtare. Ato përfshijnë:

a) një lidhje detare dhe lidhjet e saj në brendësi të tokës me rrjetin kryesor, ndërmjet dy ose më shumë porteve të rrjetit kryesor; ose

b) një lidhje detare dhe lidhjet e saj në brendësi të tokës ndërmjet një porti të rrjetit kryesor dhe porteve të rrjetit gjithëpërfshirës, duke i kushtuar vëmendje të veçantë lidhjeve ujore në brendësi të tokës të porteve të rrjetit kryesor dhe gjithëpërfshirës.

3. Gjithashtu, projektet me interes të përbashkët në autostradat detare në rrjetin trans-Evropian të transportit mund të përfshijnë aktivitete me përfitime më të gjera dhe që nuk lidhen me porte specifike, si p.sh. shërbimet dhe veprimet për mbështetjen e lëvizshmërisë së personave dhe të mallrave, aktivitetet për përmirësimin e performancës mjedisore, si p.sh. furnizimi me energji elektrike përmes rrjeteve tokësore, që do ndihmonte në reduktimin e shkarkimeve të anijeve, vënia në dispozicion e mjeteve për thyerjen e akullit, aktivitetet që garantojnë lundrueshmërinë gjatë gjithë vitit, operacionet e pastrimit dhe impiantet alternative të furnizimit me karburant, si dhe ato për optimizimin e proceseve, procedurave dhe elementit njerëzor, platformat TIK dhe sistemet e informacionit, duke përfshirë sistemet për administrimin e trafikut dhe sistemet elektronike të raportimit.

4. Brenda dy vitesh nga caktimi në përputhje me nenin 45, Koordinatori Evropian për autostradat detare paraqet një plan të hollësishëm zbatimi për autostradat detare, bazuar në përvojat dhe zhvillimet lidhur me transportin detar në Bashkimin Evropian, si dhe në trafikun e parashikuar në autostradat detare.

Neni 22

Kërkesat e infrastrukturës së transportit

1. Shtetet anëtare garantojnë që:

a) portet detare të jenë të lidhura me linjat hekurudhore ose rrugët dhe, aty ku është e mundur, me rrugët e brendshme ujore të rrjetit gjithëpërfshirës, përveç rastit kur kufizimet fizike e pengojnë këtë lidhje;

b) çdo port detar që ofron trafikun e mallrave të ofrojë në mënyrë jodiskriminuese të paktën një terminal që është i hapur për përdoruesit dhe që zbaton tarifa transparente;

c) kanalet detare, kanalet e hyrjes në port dhe estuaret (*grykë derdhje e gjerë*), të lidhin dy dete ose të sigurojnë aksesin nga deti për portet detare dhe të jenë të paktën të klasës VI të rrugëve të brendshme ujore.

2. Shtetet anëtare garantojnë që portet të përfshijnë pajisjet e nevojshme për të ndihmuar performancën mjedisore të anijeve në porte, në veçanti impiantet për mbledhjen e mbetjeve të krijuara nga anijet dhe mbetjet e ngarkesave, në përputhje me Direktivën

2000/59/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit¹⁶) dhe në përputhje me ligjet e tjera përkatëse të Bashkimit Evropian.

3. Shtetet anëtare zbatojnë VTMISS dhe "SafeSeaNet", siç parashikohet në Direktivën 2002/59/KE dhe përdorin shërbimet elektronike të transportit detar, duke përfshirë në veçanti shërbimet detare në një dritare të vetme, siç parashikohet në Direktivën 2010/65/BE.

Neni 23

Prioritetet për zhvillimin e infrastrukturës detare

Për promovimin e projekteve me interes të përbashkët në lidhje me infrastrukturën detare, dhe në shtesë të prioritetëve të përcaktuara në nenin 10, prioritet kanë:

- a) promovimi i autostradave detare, përfshirë udhëtimet e shkurtra detare, që lehtësojnë zhvillimin e rrugëve ujore në brendësi të tokës dhe, në mënyrë të veçantë, zhvillojnë masa për përmirësimin e performancës mjedisore të transportit detar në përputhje me kërkesat e zbatueshme sipas legjislacionit të Bashkimit Evropian ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare përkatëse;
- b) ndërlidhja e porteve detare me rrugët e brendshme ujore;
- c) zbatimin e VTMISS dhe të shërbimeve elektronike të transportit detar;
- d) futja e teknologjive të reja dhe e inovacionit për promovimin e lëndëve djegëse alternative dhe të transportit detar me efikasitet energjie, duke përfshirë GNL-në;
- e) modernizimi dhe zgjerimi i kapacitetit të infrastrukturës së nevojshme për operacionet e transportit brenda zonës portuale.

SEKSIONI 5

INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT AJROR

Neni 24

Elementet e infrastrukturës

1. Në veçanti, infrastruktura e transportit ajror përfshin:
 - a) hapësirën ajrore, korridoret dhe rrugët ajrore;
 - b) aeroportet;
 - c) lidhjet e aeroporteve me mënyrat e tjera në rrjetin trans-Evropian të transportit;
 - d) pajisjet përkatëse;
 - e) sistemet e lundrimit ajror, duke përfshirë sistemin e ri evropian për administrimin e trafikut ajror ("sistemi SESAR").
2. Aeroportet duhet të përmbushin të paktën një prej kriterëve më poshtë:
 - a) për aeroportet për transportin e udhëtarëve, qarkullimi total vjetor i lëvizjes së udhëtarëve të jetë të paktën 0,1% e vëllimit total vjetor të qarkullimit të udhëtarëve në të gjitha aeroportet e Bashkimit Evropian, përveç rastit kur aeroporti në fjalë ndodhet jashtë rrezes prej 100 km nga aeroporti më i afërt në rrjetin gjithëpërfshirës ose jashtë rrezes prej 200 km, nëse zona në të cilën ai ndodhet, mbulohet nga linja hekurudhore të shpejtësisë së lartë;
 - b) për aeroportet për transportin e mallrave, vëllimi total i qarkullimit vjetor të mallrave të jetë të paktën 0,2% e vëllimit total të qarkullimit vjetor të mallrave në të gjithë aeroportet e Bashkimit Evropian.

¹⁶ Direktiva 2000/59/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 27 nëntor 2000 "Për impiantet portuale për mbledhjen e mbetjeve të krijuara nga anijet dhe mbetjet e ngarkesave" (Gazeta Zyrtare L 332, 28.12.2000, f. 81).

Vëllimi total vjetor për qarkullimin e udhëtarëve dhe vëllimi total vjetor për qarkullimin e ngarkesave bazohen në mesataren më të fundit trevjeçare, të botuar nga Eurostat.

Neni 25

Kërkesat e infrastrukturës së transportit

Shtetet anëtare garantojnë:

1. që çdo aeroport që ndodhet në territorin e tyre të ofrojë në mënyrë jodiskriminuese të paktën një terminal që është i hapur për të gjithë operatorët, dhe që zbaton tarifa transparente, relevante dhe të drejta.

2. zbatimin e standardeve të përbashkëta kryesor për mbrojtjen e aviacionit civil nga aktet e ndërhyrjes së paligjshme, të miratuara nga Bashkimi Evropian në përputhje me Rregulloren (KE) nr. 300/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit¹⁷⁾, në infrastrukturën e transportit ajror të rrjetit gjithëpërfshirës.

3. që infrastruktura e administrimit të trafikut ajror lejon zbatimin e qiellit të vetëm evropian, në përputhje me Rregulloren (KE) nr. 549/2004 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit¹⁸⁾, Rregulloren (KE) nr. 550/2004 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit¹⁹⁾, Rregulloren (KE) nr. 551/2004 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit²⁰⁾ dhe Rregulloren (KE) nr. 552/2004 dhe të operacioneve të transportit ajror, me qëllim përmirësimin e performancës dhe të qëndrueshmërisë së sistemit evropian të aviacionit, të rregullave zbatuese dhe të specifikimeve të Bashkimit Evropian.

Neni 26

Prioritetet për zhvillimin e infrastrukturës së transportit ajror

Për promovimin e projekteve me interes të përbashkët në lidhje me infrastrukturën e transportit ajror, dhe në shtesë të prioriteve të përcaktuara në nenin 10, prioritet kanë:

- a) rritja e kapacitetit të aeroporteve;
- b) mbështetja e zbatimit të qiellit të vetëm evropian dhe e sistemeve të administrimit të trafikut ajror, në veçanti ato që shfrytëzojnë sistemin SESAR;
- c) përmirësimi i ndërlidhjeve multimodale ndërmjet aeroporteve dhe infrastrukturës së mënyrave të tjera të transportit;
- d) përmirësimi i qëndrueshmërisë dhe zbutja e ndikimit të transportit ajror në mjedis.

SEKSIONI 6

INFRASTRUKTURA PËR TRANSPORTIN MULTIMODAL

Neni 27

Elementet e infrastrukturës

¹⁷ Rregullorja (KE) nr. 300/2008 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 mars 2008 “Për rregullat e përbashkëta në fushën e sigurisë së aviacionit civil” dhe që shfuqizon Rregulloren (KE) nr. 2320/2002 (Gazeta Zyrtare L 97, 9.4.2008, f. 72).

¹⁸ Rregullorja (KE) nr. 549/2004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 10 mars 2004 “Për përcaktimin e kuadrit për krijimin e qiellit të vetëm evropian” (Rregullorja kuadër) (Gazeta Zyrtare L 96, 31.3.2004, f. 1).

¹⁹ Rregullorja (KE) nr. 550/2004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 10 mars 2004 “Për sigurimin e shërbimeve të lundrimit ajror në qiellin e vetëm evropian” (Rregullorja për ofrimin e shërbimeve) (Gazeta Zyrtare L 96, 31.3.2004, f. 10).

²⁰ Rregullorja (KE) nr. 551/2004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 10 mars 2004 “Për organizimin dhe përdorimin e hapësirës ajrore në qiellin e vetëm evropian” (Rregullorja për hapësirën ajrore) (Gazeta Zyrtare L 96, 31.3.2004, f. 20).

Terminalet e mallrave ose platformat logjistike duhet të përmbushin të paktën një prej kritereve më poshtë:

- a) vëllimi vjetor i transportit të ngarkesave, për ngarkesat rifuxho është mbi 800 000 tonë ose, për ngarkesat e ambalazuara, është mbi 0,1% të vëllimit total vjetor të ngarkesës së përpunuar në të gjithë portet detare të Bashkimit Evropian;
- b) nëse një rajon NUTS 2 nuk ka një terminal mallrash ose një platformë logjistike në përputhje me shkronjën a), terminali ose platforma në fjalë është terminali kryesor i mallrave ose platforma logjistike kryesore e përcaktuar nga shteti anëtar përkatës dhe lidhet të paktën me rrugët dhe hekurudhat e këtij rajoni NUTS 2, ose në rastin e shteteve anëtare pa sistem hekurudhor, lidhet vetëm me rrugët.

Neni 28

Kërkesat e infrastrukturës së transportit

1. Shtetet anëtare garantojnë, në mënyrë të drejtë dhe jodiskriminuese, se:

- a) mënyrat e transportit lidhen me një nga vendet si më poshtë: терминаlet e mallrave, stacionet e udhëtarëve, portet e brendshme, aeroportet dhe portet detare, me qëllimin për të mundësuar transportin multimodal të udhëtarëve dhe të mallrave;
- b) pa cenuar legjislacionin e zbatueshëm të Bashkimit Evropian dhe legjislacionin e brendshëm, терминаlet e mallrave dhe platformat logjistike, portet e brendshme dhe detare dhe aeroportet që përpunojnë ngarkesa janë të pajisura për dhënien e flukseve të informacionit brenda kësaj infrastrukture dhe ndërmjet mënyrave të transportit përgjatë zinxhirit logjistik. Këto sisteme duhet të mundësojnë në mënyrë të veçantë dhënien e informacionit në kohë reale për kapacitetin e disponueshëm të infrastrukturës, për flukset e trafikut dhe pozicionimin, dhe lokalizimin dhe gjurmimin, dhe të garantojnë sigurinë në të gjithë udhëtimet multimodale;
- c) pa cenuar legjislacionin e zbatueshëm të Bashkimit Evropian dhe të brendshëm, qarkullimi i vazhdueshëm i udhëtarëve në të gjithë rrjetin gjithëpërfshirës lehtësohet përmes pajisjeve të përshtatshme dhe disponueshmërisë së aplikacioneve telematike në stacionet hekurudhore, në stacionet e autobusëve, në aeroporte dhe, sipas rastit, në portet detare dhe ato të rrugëve të brendshme ujore.

2. Терминаlet e mallrave pajisen me vinça, transportues dhe mjete të tjera për lëvizjen e mallrave ndërmjet mënyrave të ndryshme të transportit dhe për pozicionimin dhe magazinimin e mallrave.

Neni 29

Prioritetet për zhvillimin e infrastrukturës së transportit multimodal

Për promovimin e projekteve me interes të përbashkët në lidhje me infrastrukturën e transportit multimodal, dhe në shtesë të prioriteteve të përgjithshme të përcaktuara në nenin 10, prioritet kanë:

- a) sigurimi i ndërlidhjes dhe integritit efikas të infrastrukturës së rrjetit gjithëpërfshirës, duke përfshirë ku është e nevojshme, përmes infrastrukturës lidhëse, dhe përmes terminaleve të mallrave dhe platformave logjistike;
- b) eliminimi i barrierave kryesore teknike dhe administrative për transportin multimodal;
- c) zhvillimi i fluksit normal të informacionit ndërmjet mënyrave të transportit dhe mundësimi i ofrimit të shërbimeve multimodale dhe me një mënyrë transporti në të gjithë sistemin trans-Evropian të transportit.

SEKSIONI 7 DISPOZITA TË PËRBASHKËTA

Neni 30 **Nyjet urbane**

Gjatë zhvillimit të rrjetit gjithëpërfshirës në nyjet urbane, aty ku është e realizueshme, shtetet anëtare synojnë të garantojnë:

- a) për transportin e udhëtarëve: ndërlidhjen ndërmjet hekurudhave, rrugëve, ajrit dhe, sipas rastit, rrugëve të brendshme ujore dhe infrastrukturës detare të rrjetit gjithëpërfshirës;
- b) për transportin e mallrave: ndërlidhjen ndërmjet hekurudhave, rrugëve dhe, sipas rastit, rrugëve të brendshme ujore dhe infrastrukturës detare të rrjetit gjithëpërfshirës;
- c) lidhjet e përshtatshme ndërmjet stacioneve të ndryshme hekurudhore, porteve ose aeroportëve të rrjetit gjithëpërfshirës në një nyje urbane;
- d) lidhjet e pandërprera ndërmjet infrastrukturës të rrjetit gjithëpërfshirës dhe infrastrukturës së qarkullimit rajonal dhe lokal dhe të lëvrimin të mallrave në zonat urbane, duke përfshirë konsolidimin logjistik dhe qendrat e shpërndarjes;
- e) zbutjen e ekspozimit të zonave urbane ndaj ndikimeve negative të tranzitit të transportit hekurudhor dhe rrugor, të cilat mund të përfshijnë anashkalimin e zonave urbane;
- f) nxitjen e lëvrimin të mallrave në zonat urbane në mënyrë efikase, dhe me nivele të ulëta zhurme dhe karboni.

Neni 31 **Aplikacionet telematike**

1. Aplikacionet telematike duhet të jenë të tilla që mundësojnë administrimin e trafikut dhe shkëmbimin e informacionit brenda dhe ndërmjet mënyrave të transportit në operacionet e transportit multimodal, dhe shërbimet me vlerë të shtuar në lidhje me transportin, përmirësimet për sigurinë, sigurinë dhe performancën mjedisore, si dhe procedura të thjeshtuara administrative. Aplikacionet telematike lehtësojnë lidhjet e pandërprera ndërmjet infrastrukturës së rrjetit gjithëpërfshirës dhe infrastrukturës së transportit rajonal dhe lokal.

2. Aplikacionet telematike do të përdoren, aty ku është e realizueshme, në të gjithë Bashkimin Evropian, me qëllim mundësimin e ekzistencës së një grupimi të kapaciteteve kryesor të ndërveprueshme në të gjithë Bashkimin Evropian.

3. Aplikacionet telematike të përmendura në këtë nen, sipas mënyrave përkatëse të transportit, përfshijnë në veçanti:

- për hekurudhat: ERTMS;
- për rrugët e brendshme ujore: RIS;
- për transportin rrugor: ITS;
- për transportin detar: VTMS dhe shërbimet elektronike të transportit detar (*e-Maritime*), duke përfshirë shërbimet në një dritare të vetme, si p.sh. shërbimet detare në një dritare të vetme, sistemet komunitare të porteve dhe sistemet përkatëse të informacionit doganor;
- për transportin ajror: sistemet e administrimit të trafikut ajror, në veçanti ato që rezultojnë nga sistemi SESAR.

Neni 32

Shërbimet e qëndrueshme për transportin e mallrave

Shtetet anëtare i kushtojnë vëmendje të veçantë projekteve me interes të përbashkët, të cilat sigurojnë shërbime efikase për transportin e mallrave që përdorin infrastrukturën e rrjetit gjithëpërfshirës dhe kontribuojnë në uljen e shkarkimeve të dioksidit të karbonit dhe të ndikimeve të tjera në mjedis, dhe që synojnë:

- a) rritjen e përdorimit të qëndrueshëm të infrastrukturës së transportit, duke përfshirë administrimin efikas;
- b) nxitjen e përdorimit të shërbimeve inovative të transportit, duke përfshirë autostradat detare, aplikacionet telematike dhe zhvillimin e infrastrukturës ndihmëse, kryesisht të nevojshme për arritjen e objektivave mjedisore dhe të sigurisë për këto shërbime, si dhe për ngritjen e strukturave qeverisëse përkatëse;
- c) lehtësimin e operacioneve të shërbimeve të transportit multimodal, duke përfshirë flukset shoqëruese të nevojshme të informacionit, si dhe përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet ofruesve të shërbimit të transportit;
- d) nxitjen e efikasitetit në lidhje me burimet dhe shkarkimet e karbonit, në veçanti në fushat e tërheqjes së mjeteve, çlirimit të avujve dhe të planifikimit të sistemeve dhe të operacioneve;
- e) analizimin dhe sigurimin e informacionit mbi karakteristikat dhe performancën e flotës, kërkesat administrative dhe burimet njerëzore;
- f) përmirësimin e lidhjeve me pjesët më të cenueshme dhe të izoluarat të Bashkimit Evropian, në veçanti rajonet më të largëta, ishullore, të largëta dhe malore.

Neni 33

Teknologjitë e reja dhe inovacioni

Me qëllim që rrjeti gjithëpërfshirës të ecë në të njëjtin hap me zhvillimin dhe përdorimin e teknologjive inovative, duhet veçanërisht të synohet:

- a) mbështetja dhe nxitja e dekarbonizimit të transportit përmes kalimit në teknologjitë inovative dhe të qëndrueshme të transportit;
- b) dekarbonizimi i mundshëm për të gjitha mënyrat e transportit përmes nxitjes së efikasitetit të energjisë, futjes së sistemeve alternative shtytëse, duke përfshirë sistemet e furnizimit me energji, si dhe përmes sigurimit të infrastrukturës përkatëse. Kjo infrastrukturë mund të përfshijë rrjete dhe objekte të tjera të nevojshme për furnizimin me energji, mund të marrë në konsideratë ndërfaqen infrastrukturë-mjet dhe mund të përfshijë aplikacionet telematike;
- c) përmirësimi i sigurisë dhe qëndrueshmërisë së lëvizjes së personave dhe transportit të mallrave;
- d) përmirësimi i funksionimit, administrimit, aksesueshmërisë, ndërveprueshmërisë, multimodalitetit dhe efikasitetit të rrjetit, duke përfshirë lëshimin e biletave për transportin multimodal dhe koordinimin e orareve të udhëtimeve;
- e) nxitja e mënyrave efikase për sigurimin e informacionit të aksesueshëm dhe gjithëpërfshirës për të gjithë qytetarët, në lidhje me ndërlidhjet, ndërveprimin dhe multimodalitetin;
- f) nxitja e masave për reduktimin e kostove të jashtme, si p.sh. mbingarkimi i trafikut, dëmtimi i shëndetit dhe ndotja e çfarëdo lloji, duke përfshirë zhurmat dhe shkarkimet;
- g) futja e teknologjisë së sigurisë dhe standardeve të përputhshme të identifikimit në rrjete;
- h) përmirësimi i aftësisë ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike;

i) progresi i mëtejshëm lidhur me zhvillimin dhe përdorimin e aplikacioneve telematike brenda dhe ndërmjet mënyrave të transportit.

Neni 34

Infrastruktura e mbrojtur dhe sigurt

Shtetet anëtare kushtojnë vëmendjen e duhur për të garantuar që infrastruktura e transportit të ofrojë lëvizjet e sigurta të udhëtarëve dhe të mallrave.

Neni 35

Qëndrueshmëria e infrastrukturës ndaj ndryshimeve klimatike dhe fatkeqësive natyrore

Gjatë planifikimit të infrastrukturës, shtetet anëtare marrin në konsideratë qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike dhe fatkeqësive natyrore.

Neni 36

Mbrojtja e mjedisit

Vlerësimet mjedisore të planeve dhe projekteve do të kryhen në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian për mjedisin, duke përfshirë Direktivat 92/43/KEE²¹⁾, 2000/60/KE²²⁾, 2001/42/KE²³⁾, 2009/147/KE²⁴⁾ dhe 2011/92/BE²⁵⁾.

Neni 37

Aksesueshmëria për të gjithë përdoruesit

Infrastruktura e transportit duhet të mundësojë lëvizshmërinë dhe aksesueshmërinë pa probleme për të gjithë përdoruesit, në veçanti të moshuarit, personat me lëvizshmëri të reduktuar dhe udhëtarët me aftësi të kufizuara.

Projektimi dhe ndërtimi i infrastrukturës së transportit do të jetë në përputhje me kërkesat përkatëse të përcaktuara në legjislacionin e Bashkimit Evropian.

KAREU III

RRJETI KRYESOR

Neni 38

Identifikimi i rrjetit kryesor

1. Rrjeti kryesor, siç tregohen në hartat e përfshira në shtojcën I, përbëhet nga ato pjesë të rrjetit gjithëpërfshirës, të cilat kanë rëndësinë më të lartë strategjike për arritjen e objektivave të politikës së rrjetit trans-Evropian të transportit, dhe pasqyron kërkesën në rritje të trafikut dhe nevojën për transportin multimodal. Ai kontribuon veçanërisht në përballjen e

²¹ Direktiva e Këshillit 92/43/KEE e datës 21 maj 1992 “Për mbrojtjen e habitateve natyrore dhe florës e faunës së egër” (Gazeta Zyrtare L 206, 22.7.1992, f. 7).

²² Direktiva 2000/60/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 tetor 2000 “Për krijimin e një kuadri për veprimin e Komunitetit në fushën e politikës për ujën” (Gazeta Zyrtare L 327, 22.12.2000, f. 1).

²³ Direktiva 2001/42/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 27 qershor 2001 “Për vlerësimin e ndikimeve në mjedis të disa planeve dhe programeve” (Gazeta Zyrtare L 197, 21.7.2001, f. 30).

²⁴ Direktiva 2009/147/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 30 nëntor 2009 “Për ruajtjen e zogjve të egër” (Gazeta Zyrtare L 20, 26.1.2010, f. 7).

²⁵ - Direktiva 2011/92/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 dhjetor 2011, “Për vlerësimin e ndikimeve në mjedis të disa projekteve dhe programeve publike dhe private” (OJ 26, 8.1.2012, p.1)

rritjes së lëvizshmërisë dhe në garantimin sipas standardeve të larta për sigurinë, si dhe kontribuon në zhvillimin e sistemit të transportit me karbon të ulët.

2. Rrjeti kryesor ndërlidhet në nyja dhe siguron lidhjet ndërmjet rrjeteve të shteteve anëtare dhe lidhjen me rrjetet e infrastrukturave të transportit të vendeve fqinje.

3. Pa cenuar nenin 1, paragrafi 4 dhe nenin 41, paragrafët 2 dhe 3, shtetet anëtare marrin masat e përshtatshme për zhvillimin e rrjetit kryesor, me qëllim përmbushjen e dispozitave të këtij kapitulli deri më 31 dhjetor 2030.

Në përputhje me nenin 54, realizimi i rrjetit kryesor do të vlerësohet nga Komisioni deri më 31 dhjetor 2023.

Neni 39

Kërkesat e infrastrukturës

1. Teknologjitë inovative, aplikacionet telematike dhe masat rregullatore dhe qeverisëse për administrimin e përdorimit të infrastrukturës, merren në konsideratë për të garantuar përdorimin efikas të burimeve të infrastrukturës së transportit, si për udhëtarët, ashtu dhe për transportin e mallrave, si dhe për të siguruar kapacitetin e mjaftueshëm.

2. Infrastruktura e rrjetit kryesor duhet të përmbushë të gjitha kërkesat e përcaktuara në kapitullin II. Gjithashtu, pa cenuar paragrafin 3, infrastruktura e rrjetit kryesor duhet të përmbushë kërkesat si më poshtë:

a) për infrastrukturën e transportit hekurudhor:

i) elektrifikimi i plotë i linjave hekurudhore dhe, në masën e nevojshme, i linjave dytësore për operimin e trenave elektrikë;

ii) linjat hekurudhore për transportin e mallrave në rrjetin kryesor që jepen në Shtojcën I: ngarkesë për aks të paktën 22,5 t, shpejtësi linje 100 km/h dhe mundësi të lëvizjes së trenave me gjatësi 740 m;

iii) implementimi i plotë i ERTMS;

iv) gjerësia nominale e rrugës për linjat e reja hekurudhore: 1435 mm, me përjashtim të rasteve kur linja e re hekurudhore është zgjatim në një rrjet në të cilin gjerësia e linjës është e ndryshme dhe ky rrjet është i ndarë nga linjat kryesore hekurudhore në Bashkimin Evropian.

Rrjetet e izoluarra përjashtohen nga kërkesat (i) deri në (iii);

b) për rrugët e brendshme ujore dhe infrastrukturën e transportit detar:

— disponueshmëria e lëndëve djegëse alternative të pastra;

c) për infrastrukturën e transportit rrugor:

— kërkesat sipas nenit 17, paragrafi 3, shkronjat a) ose b);

— zhvillimi i zonave të qëndrimit në autostrada afërsisht në çdo 100 km, në përputhje me nevojat e shoqërisë, të tregut dhe të mjedisit, për të siguruar ndër të tjera hapësirën e përshtatshme të parkimit për përdoruesit e mjeteve tregtare në rrugë, në nivelin e duhur të sigurisë;

— disponueshmëria e lëndëve djegëse alternative të pastra;

d) për infrastrukturën e transportit ajror:

— kapaciteti për vënien në dispozicion të lëndëve djegëse alternative të pastra.

3. Pa cenuar Direktivën 2008/57/KE, me kërkesë të një shteti anëtar në lidhje me infrastrukturën e transportit hekurudhor dhe në raste të argumentuara saktë Komisioni mund të bëjë përjashtime lidhur me gjatësinë e trenit, ERTMS, ngarkesën për aks, elektrifikimin dhe shpejtësinë e linjës hekurudhore.

Me kërkesë të një shteti anëtar në lidhje me infrastrukturën e transportit rrugor dhe në raste të argumentuara saktë, Komisioni mund të bëjë përjashtime nga dispozitat e nenit 17, paragrafi 3, shkronjat a) ose b), për atë kohë sa garantohet niveli i përshtatshëm i sigurisë. Rastet e argumentuara saktë të përmendura në këtë paragraf përshijnë rastet kur investimi në infrastrukturë nuk mund të justifikohet nga pikëpamja social-ekonomike e kosto-përfitimit.

Neni 40

Zhvillimi i rrjetit kryesor

Infrastruktura e transportit që përfshihet në rrjetin kryesor duhet të zhvillohet në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitullit II.

Neni 41

Nyjet e rrjetit kryesor

1. Nyjet e rrjetit kryesor përcaktohen në Shtojcën II dhe përfshijnë:

- a) nyjet urbane, duke përfshirë portet dhe aeroportet e tyre;
- b) portet detare dhe portet në rrugët e brendshme ujore;
- c) pikat e kalimit të kufirit për në shtetet fqinje;
- d) terminalët hekurudhore-rrugore;
- e) aeroportet e transportit të udhëtarëve dhe të mallrave.

2. Portet detare të rrjetit kryesor që tregohen në pjesën 2 të Shtojcës II, duhet të lidhen me infrastrukturën hekurudhore dhe rrugore dhe, aty ku është e mundur, me infrastrukturën e transportit në rrugët e brendshme ujore të rrjetit trans-Evropian të transportit, deri më 31 dhjetor 2030, përveç rastit kur kufizimet fizike e pengojnë këtë lidhje.

3. Aeroportet kryesore që tregohen në pjesën 2 të Shtojcës II, duhet të lidhen me infrastrukturën e transportit hekurudhor dhe rrugor të rrjetit trans-Evropian të transportit deri më 31 dhjetor 2050, përveç rastit kur kufizimet fizike e pengojnë këtë lidhje. Duke marrë në konsideratë kërkesën e mundshme për trafikun, këto aeroporte duhet të integrohen në rrjetin hekurudhor të shpejtësisë së lartë, kur është e mundur.

KREU IV

REALIZIMI I RRJETIT KRYESOR PËRMES KORRIDOREVE TË RRJETIT KRYESOR

Neni 42

Instrumenti i korridoreve të rrjetit kryesor

1. Korridoret e rrjetit kryesor janë një instrument për lehtësimin e realizimit të koordinuar të rrjetit kryesor. Për krijimin e transportit multimodal me efikasitet të burimeve, duke kontribuar kështu në kohezionin përmes përmirësimit të bashkëpunimit territorial, korridoret e rrjetit kryesor duhet të fokusohen në:

- a) integrimin modal,
- b) ndërveprimin, dhe
- c) zhvillimin e koordinuar të infrastrukturës, në veçanti për seksionet ndërkufitare dhe bllokimin e trafikut.

2. Korridoret e rrjetit kryesor u mundësojnë shteteve anëtare arritjen e qasjes së koordinuar dhe të sinkronizuar në lidhje me investimin në infrastrukturë, për administrimin e kapaciteteve në mënyrën më efektive të mundshme. Korridoret e rrjetit kryesor mbështesin

futjen gjithëpërfshirëse të sistemeve të ndërveprueshme të administrimit të trafikut dhe, sipas rastit, përdorimin e inovacionit dhe të teknologjive të reja.

Neni 43

Përkufizimi i korridoreve të rrjetit kryesor

1. Korridoret e rrjetit kryesor mbulojnë flukset më të rëndësishme të distancave të largëta në rrjetin kryesor, të cilat janë synuar në mënyrë të veçantë për përmirësimin e lidhjeve ndërkufitare brenda Bashkimit Evropian.

2. Korridoret e rrjetit kryesor janë multimodale dhe të hapura ndaj përfshirjes së të gjitha mënyrave të transportit që mbulohen nga kjo rregullore. Ato kalojnë të paktën në dy kufij dhe, nëse është e mundur, përfshijnë të paktën tre mënyra transporti, duke përfshirë, sipas rastit, autostradat detare.

Neni 44

Lista e korridoreve të rrjetit kryesor

1. Lista e korridoreve të rrjetit kryesor është ajo që përcaktohet në pjesën I të Shtojcës I në Rregulloren (BE) nr. 1316/2013²⁶. Shtetet anëtare marrin pjesë në këto korridore të rrjetit kryesor, siç parashikohet në këtë kapitull.

2. Komisioni vë në dispozicion hartat treguese skematike të korridoreve të rrjetit kryesor, në format lehtësisht të aksesueshëm për publikun.

Neni 45

Koordinimi i korridoreve të rrjetit kryesor

1. Për të lehtësuar realizimin e koordinuar të korridoreve të rrjetit kryesor, të ERTMS dhe të autostradave detare, Komisioni cakton një ose më shumë Koordinatorë Evropianë në marrëveshje me shtetet anëtare përkatëse dhe pas konsultimit me Parlamentin Evropian dhe me Këshillin.

2. Koordinatori Evropian zgjidhet, në mënyrë të veçantë në bazë të njohurive të tij/saj në lidhje me transportin dhe financimin dhe/ose vlerësimin social-ekonomik dhe mjedisor të projekteve madhore, si dhe të përvojës së tij/saj në lidhje me institucionet evropiane.

3. Vendimi i Komisionit për caktimin e Koordinatorit Evropian specifikon mënyrën e kryerjes së detyrave të përmendura në paragrafin 5.

4. Koordinatori Evropian vepron në emër dhe për llogari të Komisionit, i cili ofron ndihmën e nevojshme sekretariale. Kuadri i detyrave të Koordinatorit Evropian duhet të lidhet përkatësisht me një korridor të vetëm të rrjetit kryesor ose me zbatimin e ERTMS apo me zbatimin e autostradave detare.

5. Koordinatori Evropian:

a) mbështet realizimin e koordinuar të korridorit përkatës të rrjetit kryesor, dhe veçanërisht zbatimin në kohë të planit të punës për këtë korridor të rrjetit kryesor;

b) harton, së bashku me shtetet anëtare, planin e punës për korridorin dhe monitoron zbatimin e tij;

c) konsultohet me Forumin e Korridoreve në lidhje me këtë plan dhe zbatimin e tij;

²⁶ Rregullorja (BE) nr. 1316/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 dhjetor 2013 "Për krijimin e Instrumentit për Ndërlidhjen e Evropës" (*Connecting Europe Facility*), që ndryshon Rregulloren (BE) nr. 913/2010 dhe që shfuqizon Rregulloret (KE) nr. 680/2007 dhe (KE) nr. 67/2010 (shih faqen 129 të kësaj Gazete Zyrtare).

d) u raporton shteteve anëtare, Komisionit dhe, sipas rastit, të gjithë subjekteve të tjera të përfshira drejtpërdrejt në zhvillimin e korridorit të rrjetit kryesor për çdo vështirësi të hasur, dhe veçanërisht në rastin e ndalimit të zhvillimit të një korridori, duke synuar ofrimin e ndihmës prej tyre për gjetjen e zgjidhjeve të përshtatshme;

e) harton çdo vit një raport për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komisionin dhe shtetet anëtare përkatëse, në lidhje me progresin e arritur në realizimin e korridorit të rrjetit kryesor;

f) shqyrton kërkesën e shërbimeve të transportit, mundësitë e fondeve dhe financimeve për investime, dhe hapat që duhen marrë dhe kushtet që duhen përmbushur për të lehtësuar aksesin në këto fonde ose financime, si dhe jep rekomandimet përkatëse.

6. Koordinatori Evropian mund të konsultohet, së bashku me shtetet anëtare përkatëse, me autoritetet rajonale dhe lokale, me operatorët e transportit, me përdoruesit e transportit dhe me përfaqësuesit e shoqërisë civile lidhur me planin e punës dhe zbatimin e tij.

7. Shtetet anëtare përkatëse bashkëpunojnë me Koordinatorin Evropian dhe i japin atij informacionin e nevojshëm për të kryer detyrat e parashikuara në këtë nen, duke përfshirë informimin mbi zhvillimin e korridoreve për çdo plan përkatës të infrastrukturës kombëtare.

8. Pa cenuar legjislacionin e zbatueshëm të Bashkimit Evropian dhe legjislacionin e brendshëm, Komisioni mund të kërkojë mendimin e Koordinatorit Evropian gjatë shqyrtimit të aplikimeve për fonde nga Bashkimi Evropian për korridoret e rrjetit kryesor që i janë besuar koordinatorit evropian, me qëllim garantimin e konsistencës dhe të avancimit të secilit korridor.

9. Nëse Koordinatori Evropian nuk është në gjendje të kryejë detyrat e mandatit të tij/saj në mënyrë të kënaqshme dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë nen, Komisioni mund ta ndërpresë në çdo kohë këtë mandat, në marrëveshje me shtetet anëtare përkatëse. Mund të caktohet një person zëvendësues, në përputhje me procedurën e parashikuar në paragrafin 1.

Neni 46

Qeverisja e korridoreve të rrjetit kryesor

1. Për çdo korridor të rrjetit kryesor, Koordinatori Evropian përkatës do të mbështetet gjatë kryerjes së detyrave të tij/saj nga një sekretariat dhe nga një forum këshillimor (Forumi i Korridoreve) për planin e punës dhe zbatimin e tij. Forumi i Korridoreve krijohet dhe drejtohet nga Koordinatori Evropian, në marrëveshje me shtetet anëtare përkatëse. Shtetet anëtare përkatëse bien dakord për anëtarësinë e Forumit të Korridoreve, në lidhje me pjesën e tyre në korridorin e rrjetit kryesor.

2. Në marrëveshje me shtetet anëtare përkatëse, Koordinatori mund të ngrejë dhe të drejtojë grupe pune lidhur me korridoret, të cilat fokusohen në:

- a) integrimin modal,
- b) ndërveprimin,
- c) zhvillimin e koordinuar të infrastrukturës në seksionet ndërkufitare.

Neni 47

Plani i punës

1. Çdo Koordinator Evropian, deri më 22 dhjetor 2014, u dorëzon shteteve anëtare përkatëse planin e punës që analizon zhvillimin e korridorit. Pas miratimit nga shtetet anëtare përkatëse, plani i punës i dorëzohet për informacion Parlamentit Evropian, Këshillit dhe Komisionit.

Plani i punës përfshin në veçanti përkrahimin e karakteristikave, të seksioneve ndërkufitare dhe të objektivave të korridorit të rrjetit kryesor, duke zbatuar objektivat dhe prioritetet e përcaktuara në nenet 4 dhe 10. Plani i punës përfshin një analizë:

- a) të përdorimit të sistemeve të ndërveprueshme të administrimit të trafikut;
- b) të planit për eliminimin e barrierave fizike, teknike, operacionale dhe administrative, ndërmjet dhe brenda mënyrave të transportit dhe për përmirësimin e transportit dhe shërbimeve efikase multimodale;
- c) të masave, sipas rastit, për përmirësimin e kapaciteteve administrative dhe teknike për konceptimin, planifikimin, projektimin, prokurimin, zbatimin dhe monitorimin e projekteve me interes të përbashkët;
- d) të ndikimeve të mundshme të ndryshimeve klimatike në infrastrukturë dhe, sipas rastit, të masave të propozuara për përmirësimin e qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike;
- e) të masave që duhen marrë për zbutjen e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë, të zhurmave dhe, sipas rastit, të ndikimeve të tjera negative në mjedis.

Plani i punës duhet të përfshijë hollësi lidhur me konsultimet publike, të cilat mbështesin zhvillimin e planit të punës dhe zbatimin e tij.

Plani i punës duhet të përfshijë gjithashtu një analizë të investimit të kërkuar, duke përfshirë:

— listën e projekteve për zgjerimin, rinovimin ose ripërdorimin e infrastrukturës së transportit të përmendur në nenin 2, paragrafi 2 për çdo mënyrë transporti të përfshirë në korridorin e rrjetit kryesor;

— burimet e ndryshme të parashikuara, në bashkëpunim me shtetet anëtare përkatëse, për fondet dhe financimin në nivel ndërkombëtar, kombëtar, rajonal, lokal dhe Bashkimi Evropian, duke përfshirë, ku është e mundur, sistemet e specifikuara për financimin e përbashkët dhe kapitalin privat, së bashku me shumën e angazhimeve tashmë të kryera dhe, sipas rastit, duke iu referuar kontributit të Bashkimit Evropian të parashikuar nën programet financiare të tij.

2. Duke iu nënshtuar nenit 1, paragrafi 4 dhe nenit 54, dhe pas miratimit nga shtetet anëtare përkatëse, Komisioni mund të miratojë akte zbatuese për dimensionin ndërkufitar dhe horizontal të planeve të punës për korridoret e rrjetit kryesor.

Pas miratimit, Komisioni mund t'i përshtatë këto akte zbatuese, pas miratimit të tyre nga shtetet anëtare përkatëse, që të marrin në konsideratë progresin e arritur, vonesat e hasura ose programet kombëtare të përditësuara.

Këto akte zbatuese miratohen në përputhje me procedurën e ekzaminimit të përmendur në nenin 52 paragrafi 2.

3. Koordinatorin Evropian mbështet shtetet anëtare për zbatimin e planit të punës, veçanërisht në lidhje me:

- a) planifikimin e investimeve, kostot e lidhura me të dhe afatet kohore të zbatimit, të vlerësuara si të nevojshme për realizimin e korridoreve të rrjetit kryesor;
- b) përcaktimin e masave që kanë si synim nxitjen e futjes së teknologjive të reja për administrimin e trafikut dhe të kapaciteteve dhe, sipas rastit, për reduktimin e kostove të jashtme, në veçanti shkarkimet e gazeve me efekt serrë dhe zhurmat.

Neni 48

Bashkëpunimi me korridoret hekurudhore për transportin e mallrave

1. Duhet të garantohet koordinimi i duhur ndërmjet korridoreve të rrjetit kryesor dhe korridoreve hekurudhore për transportin e mallrave të parashikuara në Rregulloren (BE)

nr. 913/2010, me qëllimin për të shmangur dublikimin e veprimtarisë, veçanërisht në rastin e hartimit të planit të punës ose të ngritjes së grupeve të punës.

2. Dispozitat e këtij kreu nuk cenojnë strukturat qeverisëse të përcaktuara në Rregulloren (BE) nr. 913/2010.

KREU V DISPOZITA TË PËRBASHKËTA

Neni 49 **Përditësimi dhe raportimi**

1. Shtetet anëtare informojnë Komisionin në mënyrë të rregullt, gjithëpërfshirëse dhe transparente në lidhje me progresin e arritur në zbatimin e projekteve dhe investimet e bëra për këtë qëllim. Ky informacion përfshin transmetimin e të dhënave vjetore, sa më shumë të jetë e mundur, përmes sistemit interaktiv të informacionit gjeografik dhe teknik të rrjetit trans-Evropian të transportit (TENtec). Ai përfshin të gjitha të dhënat përkatëse lidhur me projektet me interes të përbashkët që përfitojnë nga fondet e Bashkimit Evropian.

Komisioni garanton që "TENtec" të:

- jetë publik dhe që të aksesohet lehtësisht nga publiku, dhe përmban informacion të përditësuar dhe specifik për projektet, lidhur me natyrën dhe sasinë e bashkëfinancimit të Bashkimit Evropian, si dhe për progresin e çdo projekti.

- mos bëjë publik asnjë informacion të natyrës që përbën sekret tregtar, apo që mund të cenojë ose të ndikojë padrejtësisht në një proces prokurimi publik në një shtet anëtar.

Komisioni vë në dispozicion informacionin mbi ndihmën financiare të ofruar sipas ligjeve të tjera të Bashkimit Evropian, duke përfshirë Fondin e Kohezionit, Fondin Evropian për Zhvillimin Rajonal dhe "Horizon 2020", dhe në formën e huave dhe të instrumenteve financuese të krijuara nga Banka Evropiane e Investimeve.

2. Shtetet anëtare i dorëzojnë Komisionit ekstraktet e planeve dhe të programeve kombëtare që ato hartojnë, me synim zhvillimin e rrjetit trans-Evropian të transportit. Pasi të jenë miratuar, shtetet anëtare i dërgojnë Komisionit për informim planet dhe programet kombëtare.

3. Çdo dy vjet, duke nisur nga data 21 dhjetor 2013, Komisioni publikon një raport progresi për realizimin, i cili i dërgohet për informim Parlamentit Evropian, Këshillit, Komitetit Evropian Ekonomik dhe Social, dhe Komitetit të Rajoneve. Raporti mbulon përdorimin e të gjitha formave të asistencës financiare të përmendura në paragrafin 1, për mënyrat e ndryshme të transportit dhe elementet e tjera të rrjetit gjithëpërfshirës dhe atij kryesor në çdo shtet anëtar.

Raporti analizon, gjithashtu, zhvillimin e rrjetit trans-Evropian të transportit. Këtu theksohet edhe koordinimi i Komisionit për të gjitha format e asistencës financiare, me qëllim mbështetjen e zbatimit koherent të udhëzimeve, në përputhje me objektivat dhe prioritetet e tyre.

4. Duke iu nënshtruar paragrafit të dytë të nenit 172 të TFBE-së, Komisioni ka kompetencën për miratimin e akteve të deleguara në përputhje me nenin 53 të kësaj rregulloreje lidhur me përshtatjen e Shtojcave I dhe II, për të marrë në konsideratë ndryshimet e mundshme që rezultojnë nga kufijtë sasiorë të përcaktuar në nenet 14, 20, 24 dhe 27 të kësaj rregulloreje. Në përshtatjen e këtyre Shtojcave, Komisioni:

a) përfshin platformat logjistike, терминаlet e mallrave, терминаlet hekurudhore-rrugore, portet e brendshme, portet detare dhe aeroportet në rrjetin gjithëpërfshirës, nëse vërtetohet se mesatarja më e fundit dyvjeçare e vëllimit vjetor të qarkullimit të tyre tejkalon kufirin përkatës;

